



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 4225 prot.

Date 31.10 2022

UDHËZIM

Nr. 604, Datë 31.10

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHEZIMIN NR. 499, DATË 02.07.2019
“PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE EMËRIMIT TË MJEKËVE NË INSTITUCIONET
SHËNDETËSORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NËPËRMJET
PLATFORMËS ELEKTRONIKE” TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 419, datë 4.7.2018 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor”, me propozim të Drejtorisë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 499, datë 02.07.2019 “Për procedurat e pranimiit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike” bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në Kreun I, Të Përgjithshme, pika 5 ndryshohet dhe bëhet:

“DROSHKSH dhe DSU kanë detyrimin të përcjellin pranë DQOSHKSH vendet e lira sa herë krijohen”.

2. Në Kreun I, Të Përgjithshme, pika 6 ndryshohet dhe bëhet.

“DQOSHKSH ka detyrimin t’i publikojë vendet e lira në portalin “Mjek për Shqipërinë” si dhe përditësimin e listëpritisjes, në rast se ka një të tillë. Publikimet e vendeve të lira në portal do të bëhen menjëherë me krijimin e vendit vakant.

3. Në Kreun II, Shpallja e vendeve të lira të punës dhe aplikimi, pika 4 ndryshohet dhe bëhet:

“Kandidatët e interesuar, regjistrohen në portalin “Mjek për Shqipërinë” dhe ngarkojnë në portal dokumentat e kërkuar. Një kopje e dokumentave dërgohet pranë DROSHKSH apo Spitaleve Universitare me postë ose dorazi me protokoll.

Vakancat e krijuara për mjek të përgjithshëm/ mjek familje plotësohen menjëherë nga kandidatët e listës së pritjes sipas renditjes në portal.

Afati i aplikimit për pozicionin Mjek Specialist do të jetë një javë kalendarike. Në javën në vijim Komisioni i Vlerësimit vijon më procedurën e Faza I dhe Faza II si dhe përmbylljen e procesit të punësimit për vendet e lira të publikuara”.

4. Në Kreun III, Vlerësimi dhe Emërimi, pika 2 ndryshohet dhe bëhet:

“Komisioni i Vlerësimit, brenda 24 orëve (1 ditë pune) pas përfundimit të afatit të pranimit për çdo aplikim të ri, vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe përcjell për publikim pranë DQOSHKSH emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e pranimit. DQOSHKSH publikon në vijim listën e kandidatëve të cilët njoftohen via e-mail nga Komisioni i Vlerësimit në të njëjtën ditë si për vlerësimin e dosjes ashtu si dhe për vendin, datën dhe orën e zhvillimit të Fazës II. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit të vlerësimit 24 orë që nga marrja e njoftimit via e-mail. Ankesa bëhet nëpërmjet portalit “Mjekë për Shqipërinë”. Komisioni i Vlerësimit njofton me email dhe kandidatët që nuk janë kualifikuar për arsyet e moskualifikimit”.

Pika 3 dhe 4 shfuqizohen.

5. Në Kreun III, Vlerësimi dhe Emërimi, pika 5 ndryshohet dhe bëhet:

“Komisioni i Vlerësimit ditën e intervistës përgatit pyetjet të cilat duhet të jenë të njëjta për të gjithë kandidatët. Në përfundim hartohet lista me pikët totale për çdo kandidat dhe brenda 24 orëve i njofton ata për rezultatin, nëpërmjet adresës së tyre me email. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit për rezultatin përfundimtar, brenda 24 orëve nga dita e njoftimit të tyre. Ankesa bëhet përmes portalit “Mjekë për Shqipërinë””.

Pika 6 shfuqizohet.

6. Në Kreun III, Vlerësimi dhe Emërimi, pika 9 ndryshohet dhe bëhet:

“Kandidati mjek familje/mjek i përgjithshëm i cili në renditjen e përgjithshme sipas NJVKSH-ve është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën për të qenë i pari në përzgjedhjen e vendit të lirë të punës në institucionet shëndetësore përkatëse. Kandidati që nuk paraqitet, mbetet në listën e pritjes me të njëjtat pikë”.

7. Në Kreun III, Vlerësimi dhe Emërimi, pika 13 ndryshohet dhe bëhet:

“DQOSHKSH/sptali universitar dokumenton procesin e zgjedhjes së vendeve të punës për çdo kandidat si dhe raportin menjëherë, me postë elektronike dhe me shkresë zyrtare në DQOSHKSH si dhe në MSHMS për emërimet/refuzimet apo moskonfirmimet e kandidatëve”.

8. Në Kreun III, Vlerësimi dhe Emërimi, pika 15 ndryshohet dhe bëhet:

“Kandidatët mjek familje/mjek të përgjithshëm, për të cilët nuk ka një vend vakant, qëndrojnë në listën e pritjes për një vend pune në NJVKSH ku është kualifikuar dhe thirren për përzgjedhje të vendeve vakant sapo të ketë shpallje të reja”.

9. Në Kreun III, Vlerësimi dhe Emërimi, shtohet në fund pika 17 me përmbajtje:

“Në rastin e krijimit të vendeve të lira të përkohshme, pozicionet plotësohen nga kandidatët fitues në listë pritje, të cilët njoftohen sipas renditjes me pikë. Kandidatët të cilët kanë përzgjedhur një vend pune si zëvendësues, për mjek familje/mjek të përgjithshëm (leje barrë lindje, pezullirje etj), ruajnë renditjen në listë pritje sipas pikëve deri në përmbushjen e kontratës dhe me përmbylljen e saj, bëhen sërish pjesë e njoftimeve për vendet e lira të krijuara në institucionet shëndetësore”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

